



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE
SEKTORI I PROKURIMEVE

Nr. _____prot.

Durrës, më _____.____.2023

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
(PAS PËRFUNDIMIT TË AFATEVE TË ANKIMIT)

[16.06.2023]

Drejtuar: BOE “BEQIRI” shpk me NIPT: J98624801V + “B93 II” shpk me NIPT: L522090500 + “B-93” shpk me NIPT: J62903508R , me adresë: Fier Lagja 15 Tetori, Rruga “Todi Shkurta”, Pallati 10 katesh me nr-47/2, kati 2

Procedura e prokurimit/lotit: Procedurë e Hapur Pune

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-63767-03-27-2023

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Rehabitimi i ndricimit te akseve rrugore”

Fondi limit: 41’611’645 (dyzetë e një milion e gjashtëqind e njëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzetë e pesë), pa TVSH

Kohëzgjatja e kontratës: 56 (ditë)

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini datë 3 Prill 2023 , Nr. 30.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. BOE SARDO shpk me NIPT: K13120402W + ALB SHPRESA shpk me NIPT: J72110003F me Vlerë të ofertës 32.262.900 (tridhjetë e dy milion e dyqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e nëntëqind) lekë.
2. RAFIN COMPANY shpk me NIPT: L52125110A me vlerë të ofertës 32.674.550 lekë (tridhjetë e dy milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e pesëqind e pesëdhjetë) lekë.

3. BOE C O L O M B O shpk me NIPT: J82916489E + BLERIMI shpk me NIPT: J62903384G me vlerë të ofertës 33.294.380 (tridhjetë e tre milion e dyqind e nëntëdhjetë e katër mijë e treqind e tetëdhjetë) lekë
4. BOE “BEQIRI” shpk me NIPT: J98624801V + “B93 II” shpk me NIPT: L522090500 + “B-93” shpk me NIPT: J62903508R me vlerë të ofertës 34.282.500 (tridhjetë e katër milion e dyqind e tetëdhjetë e dy mijë e pesëqind) lekë
5. BOE HTM shpk me NIPT: K97006004D + AL-ASFALT shpk me NIPT: K81511508A me vlerë të ofertës 37.492.450 (tridhjetë e shtatë milion e katërqind e nëntëdhjetë e dy mijë e katërqind e pesëdhjetë) lekë
6. BOE ASI-2A CO shpk me NIPT: K53002402C + 2Z KONSTRUKSION shpk me NIPT: J63229466K me vlerë të ofertës 38.085.050 (tridhjetë e tetë milion e tetëdhjetë e pesë mijë e pesëdhjetë) lekë
7. BOE ELAL COM shpk me NIPT: K72418010P + MELA. shpk me NIPT: K62320011G me vlerë të ofertës 39.710.850 (tridhjetë e nëntë milion e shtatëqind e dhjetë mijë e tetëqind e pesëdhjetë) lekë

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. SARDO shpk me NIPT: K13120402W + ALB SHPRESA shpk me NIPT: J72110003F, me vlerë të ofertës **32.262.900 lekë**, Komisioni i Vleresimit të Ofertave, gjatë shqyrtimit dhe vleresimit të dokumentacionit, konstatoi se, ofertuesi **SARDO shpk + ALB SHPRESA shpk**:

1. Nuk permbush piken 2.3.c të Kapacitetit Teknik, ku citohet se “*Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë: Inxhinier Elektrik 1 (një)*”, pasi referuar akt marrveshjes së bashkepunimit për bashkimin e operatoreve ekonomik, operatori ekonomik SARDO ka marrë persiper punime elektrike, konkretisht preventivin e plote për 4 akse rrugore, dhe nuk ka vetedeklaruar asnjë personel në permbushje të këtij kriteri.

2. Nuk permbush piken 2.3.d të Kapacitetit Teknik, ku citohet se “*Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë: Inxhinier Ndërtimi 1 (një); Puntor të thjeshtë 25 (njëzet e pesë)*”, pasi referuar akt marrveshjes së bashkepunimit për bashkimin e operatoreve ekonomik, operatori ekonomik SARDO ka marrë persiper punime ndërtimi, konkretisht preventivin e plote për 4 akse rrugore, dhe nuk ka vetedeklaruar asnjë personel inxhinier ndërtimi dhe asnjë punëtor të thjeshtë në permbushje të këtij kriteri.

3. Nuk permbush piken 2.3.e të Kapacitetit Teknik, ku citohet se “*Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë: Teknik Ndërtimi 3 (tre); Elektracist 17 (shtatëmbëdhjetë); Teknik Elektroteknik 2 (dy); Manovratorë 1 (një); Drejtues Mjeti 3 (tre)*”, pasi referuar akt marrveshjes së bashkepunimit për bashkimin e operatoreve ekonomik, operatori ekonomik SARDO ka marrë persiper punime të specializuara sipas

profesioneve te siperctuara, konkretisht preventivin e plote per 4 akse rrugore, dhe nuk ka vetedeklaruar asnje personel teknik ndertimi dhe asnje manovrator ne permbushje te ketij kriteri.

Ne konstatimet e mesiperme, Komisioni i Vleresimit te Ofertave eshte bazuar edhe ne Vendimin e Komisionit te Prokurimit Publik nr.1129/2022, date 22.11.2022.

4. Operatori ekonomik SARDO, ne te njejten kohe, ka ne zbatim kontratat me objekt “*Riforcimi pallateve me kod gis: 25759, 25583, 22842, 22243, 22248, 22866, 24812, 22707, 25248, 22721, 24821, 22245, 22299*”, dhe “*Riforcim i godinave pallat me kod gis 1569, 27348, 27501*”, duke angazhuar ne kete menyre pjese te punonjesve dhe mjeteve/pajisjeve te vetedeklaruara per kete procedure prokurimi.

Ne kete konstatim Komisioni i Vleresimit te Ofertave eshte bazuar ne rekomandimet e Kontrollit te Larte te Shtetit gjate auditimit ne institucionin tone.

2. RAFIN COMPANY shpk me NIPT: L52125110A, me subjekt mbeshtetes NDREGJONI dhe UDHA, me vlerë të ofertës **32.674.550 lekë**, Komisioni i Vleresimit te Ofertave, gjate shqyrtimit dhe vleresimit te dokumentacionit per permbushjen e kriterëve per kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se:

I. Operatori ekonomik **NDREGJONI**, subjekt mbeshtetes i **RAFIN COMPANY shpk**, ka deklaruar kapacitet njerezor ne mbeshtetje te **RAFIN COMPANY shpk** punonjesit: Z.Besnik Kalia, i punesuar si teknik ndertimi, Z.Agron Llana, i punesuar si elektrikist, Z.Edison Ndregjoni i punesuar si elektrikist.

Punonjesit e siperpermendur jane te angazhuar ne kontraten e lidhur midis **NDREGJONI** dhe **BASHKIA DURRES** per proceduren me objekt “*Riforcimi pallateve me kod gis: 26311, 26028, 26194, 25958, 27429, 5403, riforcimi i baneses individuale në njësinë administrative Nr.1 te Albina Biduli, Kujtim Cankja, Mustafa Biduli, Myzejen Xhakozi, Nexhmije Kapexhiu, Ylvie Bekteshi, riforcimi i baneses individuale në njësinë administrative Nr.2 te Mynyre Zeneli, Qazim Terniqi, Saimir Farruku, Violeta Çeka, Vjollca Verzivolli, riforcimi i baneses individuale në njësinë administrative Nr.5 te Agim Gjini, Ferik Hoxha, Lush Zina, Naim Mandri, Neritan Sulejmani, Nikoll Dunga, Shpetim Hoxhaj, Skender/Viktor Golemi, Spanja Perfundi, riforcimi i baneses individuale në njësinë administrative Nr.6 te Besi Hilaj, Ilirjan Rusi, Rakip Allmeta, Sami Tafa, Tefta Hidri*” kontrate e lidhur ne **date:18.10.2022** me afat **224 dite**.

Si rrjedhoje ofertuesi **RAFIN COMPANY shpk** nuk permbush piken **2.3.e** te dokumentave te tenderit (per disponimin e punojnesve te specializuar/kualifikuar)

3. C O L O M B O shpk me NIPT: J82916489E + BLERIMI shpk me NIPT: J62903384G, me vlerë të ofertës **33.294.380 lekë**, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se dokumentat provuese të paraqitura nga BOE “**COLOMBO**” shpk + “**Blerimi**” shpk, të listuara si më sipër, kanë devijime dhe mospërputhje në vetëdeklarimet e tyre sipas shtojces nr. 8, me konkretisht:

Mjeti me targe AA479FO, i vetedeklaruar ne Formularin Permbledhes se Vetedeklarimit sipas Shtojces 8 si kamion me mase maksimale te autorizuar 7.5-18 ton, pas verifikimit te

dokumentacionit fizik, Leje Qarkullimi, mjeti i mësipërme rezulton se masa maksimale e autorizuar është 26 ton, duke e kaluar kriterin e vendosur në DST i cili është: Kamion me masë maksimale të autorizuar 7.5– 18 ton. Gjithashtu nga verifikimi i dokumentacionit fizik rezulton se mjeti me targe AA479FO, i ka mbaruar afati i vlefshmerisë së sigurimit.

Mjeti me targe AA983SK, i vetedeklaruar në Formularin Permbledhës së Vetedeklarimit sipas Shtojcës 8 si kamion me masë 11 ton, pas verifikimit të dokumentacionit fizik, Leje Qarkullimi, mjeti i mësipërme rezulton se masa maksimale e autorizuar është 24 ton, duke e kaluar kriterin e vendosur në DST i cili është: Kamion me masë maksimale të autorizuar 7.5– 18 ton

Ndodhur në kushtet e mësipërme BOE “**COLOMBO**” shpk + “**Blerimi**” shpk, nuk disponojnë për realizimin e kontratës, Mjetet, konkretisht: Kamion me masë maksimale të autorizuar 7.5– 18 ton “Cope 2”

Në këto kushte, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranon si të parregullt dokumentacionin e paraqitur nga BOE “**COLOMBO**” shpk + “**Blerimi**” shpk

4. ASI-2A CO shpk me NIPT: K53002402C + 2Z KONSTRUKSION shpk me NIPT: J63229466K, me vlerë të ofertës **38.085.050 lekë**, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit, konstatoi se, ofertuesi **ASI-2A CO shpk + 2Z KONSTRUKSION shpk**:

1. Operatori ekonomik 2Z KONSTRUKSION shpk, bazuar në formularin permbledhës së vetedeklarimit sipas Shtojcës 8, mbështetet në kapacitetet e 4 subjekteve të tjera, të cilët nuk kanë paraqitur formularin permbledhës së vetedeklarimit, në kundërshtim me DST, ku citohet se “*Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës*”.

2. Nuk përmbush piken 2.3.b të Kapacitetit Teknik, ku citohet se “*Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme: NP-1 A Punime gërmimi në tokë; NP-11 B Ndërtim për n/stacion kabina e transformatore, linja të tn, të mesëm dhe shpërndarja e energjisë*”, pasi operatori ekonomik ASI-2A CO, referuar akt marrëveshjes së bashkëpunimit për bashkimin e operatoreve ekonomik, ka marrë persiper punime elektrike në një vlerë me të lartë se 20.000.000 leke, duke mos disponuar piken e licences NP-11 B për nivelin e punimeve elektrike të marra persiper.

5. ELAL COM shpk me NIPT: K72418010P + MELA. shpk me NIPT: K62320011G, me subjekt mbështetës 2AS INVEST, me vlerë të ofertës **39.710.850 lekë**, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit, konstatoi se, ofertuesi **ELAL COM shpk + MELA. shpk**:

1. Nuk përmbush piken 2.2.b të Kapacitetit Ekonomik dhe Financiar, të përcaktuar me Shtojcën e datës 28.03.2023, ku citohet se “*Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020, 2021, 2022, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në përputhje me Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar, i ndryshuar. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit*”, pasi

operatori ekonomik ELAL COM, ne permbushje te ketij kriteri, nuk ka paraqitur bilancin vjetor te vitit 2022.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë BOE “**BEQIRI**” shpk me NIPT: **J98624801V** + “**B93 II**” shpk me NIPT: **L522090500** + “**B-93**” shpk me NIPT: **J62903508R** , me adresë: Fier Lagja 15 Tetori, Rruga “Todi Shkurta”, Pallati 10 katesh me nr-47/2, kati 2 , se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 34.282.500 (tridhjetë e katër milion e dyqind e tettëdhjetë e dy mijë e pesëqind) lekë pa Tvsh]/pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*Bashkia Durrës, Njesia e Prokurimit, njesia.prokurimeve@durrës.gov.al*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [37’492’450 (tridhjetë e shtatë milion e katërqind e nëntëdhjetë e dy mijë e katërqind e pesëdhjetë) lekë, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak)

PO JO X

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)_____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të Procedurës:

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)_____

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
Emiriana Sako